




## Përfshirja e Romëve përmes Arsimit



**Dokument Strategjik për Shprehjen e Ambicies së BE-së:  
Edukimi i Romëve 2018-2028,**

prezantuar gjatë takimit ndërkombëtar të projektit "**Ambasadorët  
Romë**" Brasov, Rumani, Korrik 2018



**Projekti** "Integrimi me anë të Shkëmbimit të Eksperiencave në Trajnimin e të Rinjëve Rom" (**Ambasadorët Rom**) është një iniciativë një vjecare e shkëmbimit të eksperiencave

**Financuar nga Programi Erasmus+** dhe **Qendra për Bashkëpunimin Ndërkombëtar në Arsim** e Republikës Çeke, me numër reference **2017-3-CZ01-KA205-046733**.

**Synimi** i këtij aksioni është të evidentojë, analizojë dhe shkëmbejë eksperiencat midis ekspertësh, ndërmjetësuesish dhe mësuesish në fushën e edukimit Rom dhe mundësive të punësimit.

**Qëllimi i këtij projekti** është të pregatisë një document strategjik lidhur me gjithëpërfshirjen e Romëve ndërmjet edukimit dhe një gудie trajnimi për ndërmjetësuesit Rom në fushën e punësimit.

Në këtë projekt marrin pjesë **Komunikujeme o.p.s** (Republika Çeke) si **aplikues projekti**, ndërsa partnerët janë **eduACT** (Greqi), **Asociatia MERGI INAINTE** (Rumani), **UC Limburg** (Belgjikë), **INSTITOYTO PSYCHOKOINONIKIS ANAPTYXIS** (Greqi), **OECON GROUP** (Bullgari), **Rinascita Sociale Salam House** (Itali), **JOVENES HACIA LA SOLIDARIDAD Y EL DESARROLLO** (Spanjë), **Thirst for Life Association** (Bullgari) dhe **Qendra UET** (Shqipëri).


## PËRMBAJTJA

1.	Hyrje	p. 3
2.	Pengesat e Arsimit në Shkolla	p. 8
3.	Shtyllat për Mbështetjen e Edukimit të të Rinjëve Romë	p. 10
4.	Sigurimi i Mjeteve Fianciare dhe Institucionale për Zbatimin e Politikave Kombëtare në Nivel Lokal	p. 14
5.	Krijimi i Ndërveprimit midis Axhendës së të Drejtave të Njeriut dhe Axhendës së Efikasitetit Ekonomik	p. 16
6.	I Jepet Rëndësi Pjesëmarrjes së Romëve	p. 16
7.	Partneritete për Promovimin e Asaj Çka Funkcionon	p. 18
8.	Rekomandime	p. 20
9.	Përfundime	p. 20

## HYRJE

Rezultatet e anketës së vitit 2011 në 11 Shtete Anëtare të BE-së dhe BE-së MIDIS 2016 **Anketa FRA** që mbulon 9 Shtete Anëtare të BE-së konfirmonë se kryesisht fëmijët romë janë prapa në arritjet arsimore dhe tregojnë një hendek të konsiderueshëm midis fëmijëve romë dhe atyre jo-romë që ndjekin shkollimin. Përkundër përpjekjeve për zgjerimin dhe përmirësimin e arsimit të fëmijëve romë gjatë viteve, deri në 50% e fëmijëve romë në Evropë dështojnë të përfundojnë arsimin fillor dhe vetëm një e katërta përfundon arsimin e mesëm të plotë. Pjesëmarrja në shkolla bie ndjeshëm pas arsimit të detyrueshëm, ku vetëm 15% e të rinjve romë kanë përfunduar arsimin e përgjithshëm të mesëm ose të lartë profesional. Nivelet e analfabetizmit në mesin e të rinjve romë mbeten relativisht të larta për Europën ku pothuajse 50% e romëve janë analfabetë ose mesatarisht të shkolluar. Pa përfundimin e arsimit të detyrueshëm, shumë të rinjë romë nuk janë në gjendje të plotësojnë kërkesat themelore për programet e arsimit profesional. Këto shkallë të ulëta të pjesëmarrjes në shkolla për fëmijët dhe të rinjtë Romë egjiptianë janë veçanërisht alarmuese pasi faktorët edukativ kanë një ndikim të drejtpërdrejtë dhe akut në shanset e të ardhmes. **Ajo që doli nga të dhënat është se të rinjtë romë janë deri diku më të pafavorizuarit në BE.**

### Anketimi i dytë i minoriteteve dhe diskriminimit në Bashkimin European në vitin 2016 (EU-MIDIS II):

<b>30%</b> 30% e fëmijëve romë jetojnë në familje, ku dikush ka shkuar në shtrat të uritur të paktën një herë në muajin e kaluar	<b>53%</b> e fëmijëve romë ndjekin arsimin fillor shpesh më pak se gjysma e përqindjes së fëmijëve të moshës së tyre nga popullata e përgjithshme në të njëjtin vend	<b>41%</b> e romëve mendojnë se janë diskriminuar gjatë 5 viteve të fundit në situata të përditshme si kërkimi për punë, në punë, strehim, shëndetësi dhe arsim
<b>82%</b> e romëve nuk janë në dijeni se ka organizata që ofrojnë mbështetje për viktimat e diskriminimit.		<b>80%</b> 80% e romëve të intervistuar janë në rrezik varfërie në krahasim me mesataren e BE-së prej 17%.
<b>46%</b> 46% nuk kanë tualet shtëpie, dush ose banjo.	<b>30%</b> Vetëm 30% e romëve të anketuar janë në punë të paguar, krahasuar me normën mesatare të punësimit të BE-së për vitin 2015 prej 70%.	<b>30%</b> 30% jetojnë në shtwpi pa ujë dhe

Sondazhi identifikon perspektivat arsimore për të Rinjtë Romë dhe fëmijët si në vijim:

- **Fëmijët romë në vendet e anketuara kanë mbetur prapa bashkëmoshatarëve të tyre jo-romë në të gjithë treguesit e arsimit.**
- **Një përqindje shumë e vogël e vazhdon shkollën pas arsimit të detyrueshëm.** Të dhënat tregojnë se gjysma e romëve të moshës 15-18 vjeç nuk ndjekin shkollën (48%). 69% e fëmijëve romë në Greqi dhe 77% në Rumani në moshës së shkollës së detyrueshme e ndjekin shkollën; në të gjitha vendet e tjera të anketimit është mbi 90%. Vetëm 5% e fëmijëve romë të moshës 18-24 vjeç në nëntë shtetet anëtare e vazhdojnë shkollën.
- Ekziston një përqindje e lartë e romëve pa ndonjë arsimim formal në të gjitha grupmoshat e anketuara, veçanërisht ata që janë mbi 25 vjeç dhe të vendosur në Greqi, Portugali, Spanjë dhe Kroaci.
- **Ndarja e shkollave mbetet një problem në Bullgari, Greqi, Hungari dhe Sllovakia pavarësisht se është e ndaluar ligjërisht nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.** Slovakia (62%), Hungaria (61%) dhe Bullgaria (60%), shumica e fëmijëve romë (6-15 vjeç) ndjekin shkollat ku të gjithë ose shumica e shokëve të tyre janë romë. Megjithatë, përbërja etnike e shkollave mund të pasqyrojë përbërjen etnike të njerëzve që jetojnë pranë shkollave.



**30%** e fëmijëve romë në vendet e anketuara jetojnë në familje ku dikush ka shkuar në shtrat i uritur të paktën një herë në muajin e kaluar.

**53%** e fëmijëve të rinj romë ndjekin arsimin fillor shpesh më pak se gjysma e përqindjes së fëmijëve të moshës së tyre nga popullata e përgjithshme në të njëjtin vend.

Gjetjet e anketës tregojnë se përkundër përpjekjeve të Shteteve Anëtare, ato ende nuk përmbushin shumicën e objektivave të tyre të integritimit, element kyç i Strategjisë Kombëtare të Integritimit të Romëve të vitit 2011 të BE. Rezultatet theksojnë nevojën për:

- Përkrahja për arsimin e hershëm dhe shkollimi i integruar;
- Mundësi më të mira punësimi dhe mbrojtje më të madhe sociale për të zhdukur varfërinë;
- Arsimimi dhe trajnimi i fokusuar për të ndihmuar në mënyrë specifike të rinjtë romë dhe gratë romë në kalimin e tyre nga arsimi fillor në atë të mesëm dhe më pas për të gjetur punë;

Bazuar në hulumtimin e **projektit PAL**, megjithëse përmbajtjet kulturore dhe socio-ekonomike ndryshojnë shumë, shkollimi ose fëmijët romë / egjiptianë ngre një sërë

problemesh në të gjitha vendet e Europës: **akses i kufizuar në shkollim, frekuentim, braktisje, marginalizim dhe diskriminimi në shkolla, rezultate të dobëta ose ngelje në klasë.**

Në shumë vende, fëmijët romë ndjekin shkollat më të varfra ose përballen me diskriminim në shkolla, ku ata vetë janë pakicë. Disa fëmijë dërgohen në mënyrë të padrejtë në qendrat e "**edukimit të posatshëm**" për nxënësit me vështirësi në të mësuar. Në raste të tjera, fëmijëve mund të refuzohet pranimi në shkolla pasi kanë mungesë dokumentacioni, osë ata janë të pamundur për të ndjekur mësimin pasi jetojnë shumë larg nga vendodhja e shkollës më të afërt. **Përveç kësaj, arsimit është edhe elementi kryesor në të cilën është përmirësuar gjendja e romëve.** Më shumë fëmijë romë marrin pjesë në edukimin dhe kujdesin e fëmijërisë së hershme (53% në vitin 2016, nga 47% në 2011) - me përmirësimet më të rëndësishme në Spanjë, Sllovaki, Bullgari, Hungari dhe Rumani - duke rënë nga 87% në vitin 2011). *Këto shifra janë akoma shumë të larta dhe ndasitë në arsim mbetet një çështje në disa vende, ku më shumë se 60% e fëmijëve romë janë ndarë nga fëmijët e tjerë në Sllovaki, Hungari dhe Bullgari.*

Në raportin e vitit 2016, pas vizitës tematike në Poloni për arsimin dhe aftësimin profesional për romët, **Komiteti Ad Hoc i Ekspertëve të Çështjeve të Romëve dhe të Endacakëve (CAHROM) i Këshillit të Evropës** vuri në dukje se nuk është vënë theksi i duhur në arsimin dhe aftësimin profesional.

Arsimi profesional i referohet arsimin që përgatit të rinjtë për të punuar në tregti artizanat dhe profesione teknike nëpërmjet shkollave të specializuara teknike dhe profesionale, kolegjeve dhe instituteve, ndërsa trajnimi profesional i referohet aftësive dhe aftësimin për punë specifike.

*Arsimi dhe aftësimi profesional ende nuk njihen siç duhet si prioritete dhe zgjidhje që ofrojnë mundësi për të mobilizuar dhe fuqizuar të rinjtë Romw/Egjiptian dhe për të siguruar vetë të ardhurat e tyre ekonomike. arsimi profesional mund të shihet gjithashtu si një lloj "kalimi" në tregun e punës për ata që nuk kanë kryer arsimin e detyruar dhe kanë marrë përgjegjësi familjare në moshë të hershme. Një theks më i madh duhet të vihet në arsimin dhe aftësimin profesional si një rrjet sigurie për të rinjtë romë dhe të papunë në rrezik, ndërsa në të njëjtën kohë të shqyrtohen mënyrat e hapjes së tregut të punës për punësimin e Romëve dhe Egjiptianve.*

Ende ne gjysmën e rrugës së Dekadës së Përfshirjes së Romëve, është e qartë se ende ka shumë punë për të bërë. Progresi i bërë deri më tani nuk ka çuar në ndryshime thelbësore dhe të dukshme në jetën e përditshme të shumicës së romëve. Rritja e numrit të migrimeve të romëve nga Shtetet e Reja në Shtetet e Vjetër antare të BE-së, kanë rezultuar në reagime qeveritare të cilat janë të diskutueshme dhe shumë të politizuara. *Gjatë pesë viteve të fundit, ka pasur një rritje në grupe dhe parti ekstremiste të djathta të cilat kanë patur axhenda të qarta anti-rome po ashtu*

forma të ndryshme të dhunës kundër romëve raportohen rregullisht në të gjithë Evropën Qendrore dhe Lindore. Duke pasur parasysh gjendjen e tanishme, **Fondacioni për Arsimimin e Romëve beson se mbyllja e hendekut arsimor midis romëve dhe jo-romëve është çështje urgjente dhe prioriteti kryesor për përmirësimin e situatës së romëve në Evropën Qendrore dhe Lindore.** Kërkohen investime afatgjata e të rritura në arsimimin e romëve, së bashku me veprime më efektive për të trajtuar aspekte të tjera të përjashtimit - *punësimi, shëndetësia dhe strehimi, pasi ato kanë një efekt direkt*. Diskriminimi dhe jotoleranca ndaj Romëve është ndërthurja e të gjitha aspekteve, duke përfshirë arsimin, dhe masat duhet të marrin parasysh nevojën për të adresuar këtë prirje të rrënjësorë thellë.

Anketimi vjetor mbi rritjen e Komisionit Europian tregoi se shumë duhet të bëhet nga shtetet anëtare dhe BE për të zbatuar strategjinë e Evropës 2020 dhe për të arritur objektivat e saj kryesorë, të mbështetura nga vendet anëtare. Për një numër Shtetesh Anëtare, trajtimi i situatës së romëve në aspektin e punësimit, varfërisë dhe arsimit do të kontribuojnë në përparimin drejt punësimit dhe, objektivave të përfshirjes sociale apo arsimit në Evropën 2020. Qëllimet e integritit të romëve në BE duhet të mbulojnë, në përpjesëtim me madhësinë e popullsisë romë, katër fusha vendimtare: arsimimi, punësimi, kujdes shëndetësor dhe strehimi. Këto standarde minimale duhet të bazohen në tregues të përbashkët, të krahasueshëm dhe të besueshëm. Arritja e këtyre synimeve është e rëndësishme për të ndihmuar Shtetet ***Në fushën e qasjes në arsim, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që të gjithë fëmijët romë të kenë hapsira për arsim cilësor dhe nuk janë subjekt i diskriminimit apo ndarjes. Shtetet Anëtare duhet, si minimum, të sigurojnë krerjen e ciklit fillor. Ato gjithashtu duhet të zgjerojnë qasjen për një arsim cilësor dhe përkujdesje cilësore dhe të zvogëlojnë numrin e braktisjes së hershëme të shkollës nga arsimi i mesëm sipas strategjisë së Evropës 2020. Të rinjtë romë duhet të inkurajohen fuqishëm që të ndjekin edhe arsimin e mesëm dhe të lartë.*** Niveli arsimor brenda popullsisë romë është shumë më i ulët se pjesa tjetër e popullsisë, edhe pse situata ndryshon midis Shteteve Anëtare. Përderisa frekuentimi i shkollës fillore është i detyrueshëm në të gjitha Shtetet Anëtare, Shtetet Anëtare kanë për detyrë që të sigurojnë që arsimit fillor të jetë në dispozicion për të gjithë fëmijët në moshat e detyrueshme. Sipas dëshmive më të mira në dispozicion nga Anketa e Fuqisë Punëtore 2009, mesatarisht 97.5% e fëmijëve përfundojnë arsimin fillor në të gjithë BE-në.

Komisioni miratoi një deklaratë mbi **Edukimin dhe Kujdesin e Fëmijëve** në moshë të re, i cili theksoi se shkalla e pjesëmarrjes së fëmijëve romë është dukshëm më e ulët, megjithëse nevojat e tyre për mbështetje janë më të mëdha. Rritja e angazhimit në arsimin fillor të fëmijëve mund të luajë një rol kyç në tejkalimin e disavantazhit arsimor me të cilin përballen fëmijët romë, siç theksohet nga veprimet pilote për integrimin e romëve që aktualisht janë duke u zhvilluar në disa shtete anëtare me

kontribute nga Buxheti i BE. Bazuar në anketat e analizuara dhe informacionet e mbledhura nga ekspertët e projektit, u vendosën **7 shtylla** të përbashkëta për mbështetjen e arsimit rinor romë. Objektivat janë paraqitur shkurtimisht në tabelën e mësipërme:

<b>1</b>	<b>Angazhimi dhe motivimi i familjeve</b>	
<b>2</b>	<b>Kurrikula për Shkollën Fillore dhe Kopshtin</b>	
<b>3</b>	<b>Edukimi kreativ i fëmijëve romë</b>	
<b>4</b>	<b>Mbështetje arsimore për fëmijët dhe të rinjtë romë</b>	
<b>5</b>	<b>Zhvillimi profesional i mësimdhënies së fëmijëve romë dhe të rinjve</b>	
<b>6</b>	<b>Nxitja e Arsimit Profesional</b>	
<b>7</b>	<b>Ambasadorët Romë</b>	

## PENGESAT E ARSIMIT NË SHKOLLA

Arsimi është fusha kryesore me anë të të cilës përmirësohet gjendja e romëve. Suksesi në arsim lidhet me *reformat legjislative, strukturat gjithëpërfshirëse, pjesëmarrja në rritje e romëve, përmirësimi i kompetencave multikulturore, mbështetja e nxënësve dhe mësuesve romë dhe kontakti me prindërit*. Ndër sfidat e mbetura është ende shkalla e lartë e braktisjes së shkollës fillore, vështirësia e promovimit të tranzicionit efektiv për romët në arsimin e mesëm të lartë dhe të lartë, problematikat gjuhësore dhe diskriminimi. Për shkak të hulumtimit të bërë në mesin e zbatimit të **PROJEKTIT PAL**, fëmijët romë ende **përballen me barrierat gjuhësore dhe intolerancë etnike nga mësuesit dhe bashkëmoshatarët**. Mund të themi sipas respondentëve se kryesore pse fëmijët romë nuk kanë sukses në shkolla është **VARFËRIA**. *Problemi i braktisjes së lartë shpjegohet për shkak të varfërisë së lartë në mesin e familjeve romë dhe arsimin të kushtueshëm, për shkak të martesave të hershme dhe demotivimit nga planprogrami ekzistues*. Projekti PAL dhe rrjeti i bazuar në punën e tyre me romët dhe përvojat e gjata janë duke propozuar që iniciativat e mëposhtme të përshtaten në nivel kombëtar dhe evropian:

**REFORMA NË EDUKIM:** Shteti duhet të mbështesë romët, prindërit dhe fëmijët me pajisjet e nevojshme shkollore (stilolapsa, lapsa dhe fletore), mbështetjen mësimore (përmes mësuesve të shkollave, ndërmjetësve romë), të mësuarit të lirë kulturor dhe krijues dhe dhënien e bursave për shkollat e mesme dhe të larta. **KURRIKULUMI** i disponueshëm në shkollat në Europë nuk korrespondon me shumëllojshmërinë multikulturore dhe duhet të përshtatet në aspektin e mësimdhënies përmirësuese, motivimit, programeve specifike dhe mbështetjes shkollore, trajtimit të barabartë, ndryshimit të programit shkollor (përfshirja kulturore dhe dialogu familjar, nxitja e talenteve (kryesisht për artistë si muzika, valle dhe vepra artizanale) dhe ndryshimi i strategjisë po ashtu propozimi i një vlerësimi i aftësive inovative për fëmijët romë, bazuar në zgjidhjen e detyrave në lojëra, përbërjen dhe shprehjen e tyre nga muzikë ose imazhe. Barrierat gjuhësore mund të tejkalohen në sistemin parashkollor dhe kopshtet për fëmijët romë dhe fëmijët e emigrantëve për të mësuar gjuhën dhe për t'u përshtatur në mjedisin e ri. **Asistentët dhe ndërmjetësit romë duket të jenë një zgjidhje e mirë**. Mbështetja e edukimit do të ishte vendimtare po ashtu dhe **krijimi i kornizës kombëtare të legjislacionit dhe rrjeti i institucioneve arsimore që fuqizojnë romët janë masa pozitive**. Hulmtime të tjera janë paraqitur si pjesë e raportit "[Barazia dhe përjashtimi: kuadri anti-diskriminues i BE-së dhe tendencat në jurisprudencë, në lidhje me të drejtat e njeriut në fushën e arimit dhe punësimit](#)".

**ARSIMI GJITHËPËRFSHIRËS:** Rekomandimi i Këshillit të vitit 2000 mbi politikën për të reduktuar braktisjen e hershme të shkollës rekomandon përfshirjen e masave të synuara për grupet më të prekshme, përfshirë romët. Si vazhdim i **Deklaratës së Parisit**, Komisioni e shtoi mbështetjen e saj për **ARSIMI GJITHËPËRFSHIRËS**. **Një**



**nga prioritetet është nxitja e edukimit të fëmijëve dhe të rinjve të pafavorizuar, duke përfshirë romët, duke siguruar që sistemet e arsimit dhe trajnimit të adresojnë nevojat e tyre.** Mbështetja e zhvillimit të arsimit gjithëpërfshirës do të përmirësojë format e Vetë-Reflektimit dhe Mjeteve për përmirësimin e arsimit gjithëpërfshirës në fëmijërinë e hershme. Detaje më të hollësishme rreth çështjeve po paraqiten në dokumentin "[Romët janë të barabartë: Alternativat e varfërisë, racizmit dhe përjashtimit në arsim dhe punësim](#)". Fushata ndërgjegjësuese me titull "[Nuk është tepër vonë](#)" u mbështet si pjesë e projektit PAL dhe përfshiu më shumë se 10.000 njerëz në BE.

Romët janë mesatarisht popullatë e re në moshë. Pra, është e rëndësishme që nga ky aspekt të punohet me këtë pjesë të popullsisë e cila së shpejti do të jetë plotësisht përgjegjëse si qytetare e shteteve antare në BE. Rinia është një periudhë jete kur shumica e njerëzve kanë rebelime kundër situatës ekzistuese me shkaqe të justifikueshme ose jo. Por nëse ata janë në gjendje që ata nuk mund të humbin asgjë, sepse nuk posedojnë asgjë, ata nuk mund të humbasin statusin në shoqëri, sepse janë të përjashtuar nga shoqëria, nuk mund të kërcënojnë të ardhmen e tyre, sepse nuk kanë ndonjë shpresë, me vetëbesim të ulët, të etiketuar mbi identitetin; ata mund të bëjnë cdo gjë. Parandalimi i radikalizmit në mesin e rinisë fillon me përfshirjen, integrimin dhe nivelin dinjitoz të ekzistencës. Nëse nuk duam ti kemi vendbanimet rome si "zonë pa dalje", fole kriminale ne duhet t'u japim të rinjve një mundësi për jetë më të mirë, mundësi për kohë kreative, argëtim, sport etj. E njëjta gjë është e rëndësishme për të parandaluar braktisjen e hershme të shkollës si mundësi e dytë për arsimim. Me arsimim më të mirë do të ketë mundësi më të mira për punësim. Skenari më i keq është se rinia e tyre po kalohet në rrugë.



## PILLARS FOR SUPPORTING THE ROMA YOUTH EDUCATION

Projekti "Integrimi përmes Shkëmbimit të përvojave në Trajnimin e të Rinjve Romë" (**Ambasadorët Romë**) është një iniciativë

njévjeçare për shkëmbimin e përvojave të financuara nga Programi Erasmus + dhe Qendra për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Arsim (DZS) nga Republika Çeke me numër reference **2017-3-CZ01-KA205-046733**.

Qëllimi i projektit është të ekzaminojë, analizojë dhe shkëmbejë përvojën ndërmjet ekspertëve, ndërmjetësuesve dhe mësuesve në fushën e arsimit rom dhe mundësive të punësimit. Projekti ka për qëllim përgatitjen e një dokumenti strategjik për përfshirjen e romëve përmes edukimit dhe një udhëzues trajnimi për ndërmjetësit romë në punësim. Ekspertët e projektit kanë diskutuar dhe propozuar 7 shtylla kryesore për mbështetjen e procesit arsimor të të rinjve romë që u krijuan në përputhje me kërkimet dhe 10 Parimet Themelore të Përbashkëta mbi Përfshirjen e Romëve. *Për të krijuar një dokumenti strategjik për shprehjen e ambicies së BE-së: **Edukimi i romëve 2018-2028, është e nevojshme të implementohet***

**DISKRIMINIMIN POZITIV**. Pozicionimi i pakicave romë është ende larg nga niveli mesatar i qytetarëve të tjerë të BE dhe ka nevojë për trajtime, parandalime, mbrojtje dhe masa të posaçme. Rekomandimi ynë i përgjithshëm është që shtetet e BE-së në politikën e tyre kombëtare të parandalimit të zbatojnë diskriminimin pozitiv në fushën e arsimit. Sipas mendimit tonë, mënyra më efektive për të arritur rezultatet më të mira është sinergjia e projekteve romë dhe dokumentet e rëndësishme si Korniza e BE-së për Strategjitë Kombëtare të Integrimit të Romëve deri në vitin 2020. Ka ende shumë probleme me të cilat ballafaqohen romët dhe është e nevojshme të fokusohemi në qëllime konkrete dhe të forcojmë efektet.



**PERFUNDIMI** ynë është se **diskriminimi pozitiv për romët është pjesë e domosdoshme e strategjisë**. Në të njëjtën kohë, në mesin e pjesës tjetër të popullsisë është i nevojshëm ndërgjegjësimi në lidhje me kulturën romë dhe situatën e tyre për të pranuar masat e diskriminimit pozitiv për të shmangur një reagim negativ, protestë, gjuhë urrejtjeje dhe diskriminim tjetër të publikut. Romët duhet të marrin parasysh atë që është më e mirë për komunitetin, diskriminimi pozitiv i çon ata, nga njëra anë, në rrezikun e mbledhjes së të dhënave sipas çelësit ombëtar dhe në anën tjetër, një pozitë më të mirë fillestare.



### Shtylla nr I

#### Angazhimi dhe motivimi i familjeve

Ndërsa familja është çelësi kryesor i procesit të arsimit, ekspertët e projektit të Ambasadorit Romë propozojnë, si një shtyllë për integrimin arsimor, përfshirjen aktive të familjeve dhe prindërve romë në procesin e të mësuarit. Meqenëse vlerat familjare të komunitetit rom janë mjaft të larta, modeli i mbështetjes së prindërve dhe familjes janë mjete të rëndësishme për rritjen e përqindjes së arsimimit të fëmijëve dhe zvogëlimin e numrit të braktisjeve të shkollës.

### Me fjalë të tjera...

Prindërit romë nuk janë gjithmonë të vetëdijshëm për rëndësinë e dërgimit të fëmijëve të tyre në shkollë dhe investimet që ky system kërkon. Për rrjedhojë, ata nuk janë të përfshirë mjaftueshëm në edukimin shkollor të fëmijëve të tyre. Për arsye financiare, shumë prindër i detyrojnë fëmijët e tyre të fillojnë të punojnë në moshë të re ose të qëndrojnë në shtëpi për t'u kujdesur për vëllezërit dhe motrat e tyre. Shqetësimi më i madh i familjeve romë është gjetja e mënyrave për të përmbushur nevojat e tyre të përditshme. Martesat dhe lindjet e hershme e bëjnë të vështirë për fëmijët romë të shkojnë në shkollë. Në të vërtetë, shumë të rinj krijojnë çifte para moshës 16 vjeç dhe lindja e fëmijëve nuk i lejon vajzat të shkojnë në shkollë.

### Si mund të arrihet kjo në praktikë?

- Trajnime për Familjet, ku do të shpjegohet pse shkollimi është me rëndësi;
- Shkëmbime eksperiencash me partner të tjerë;
- Ditë specifike për familjet për të vizituar shkollën dhe lehtësirat;
- Fushata ndërgjegjësuese me qëllim motivimin



### Shtylla nr II

#### Kurrikula Opsionale e Shkollës dhe Kopshtit

Mësuesit e arsimit parashkollor, që veprojnë si "ndërmjetës kulturor", luajnë një rol vendimtar në ndihmën e fëmijëve romë për të mësuar gjuhën zyrtare të vendit dhe për të nxitur integrimin e tyre në shkollë.

Problemi i gjuhës ekziston në veçanti në vendet e Evropës Lindore ku gjuha romë, pavarësisht nga faktorë historikë dhe fakti që ajo është vetëm një gjuhë e folur, është ruajtur mirë. Sondazhet e bëra nga UNDP tregojnë se 54% e të intervistuarve romë flasin gjuhën Romë në shtëpi.

### Me fjalë të tjera...

Një pengesë tjetër kryesore është problemi i mosnjohjes së gjuhës zyrtare të vendit ku jetojnë romët. Shumica e fëmijëve romë fillojnë shkollën me një njohuri shumë të vogël të gjuhës zyrtare të vendit, gjë që e bën të pamundur që ata të avancojnë në arsimim. Prandaj ata janë në disavantazh krahasuar me nxënësit e tjerë, të cilët kanë një komandë të mirë të gjuhës dhe prandaj nuk kanë të njëjtat probleme në ecurinë e arsimimit të tyre. Nevoja për të zhvilluar materiale mësimore në gjuhën romë po bëhet gjithnjë e më e dukshme. Ekzistenca e teksteve shkollore në gjuhën romë mund të ndihmojë nxitjen e fëmijëve romë për të shkuar në shkollë dhe për të studiuar dhe gjithashtu i inkurajon prindërit e tyre që t'i dërgojnë në shkollë fëmijët.

### Si mund të arrihet kjo në praktikë?

- Përshtatja e kurrikulës së kopshteve dhe shkollave për edukimin e fëmijëve romë;
- Libra trajnuar në gjuhën Romë;
- Trajnimi i asistentëve të shkollave, ndërmjetësuesve dhe koordinatorëve romë dhe mësuesve të kopshteve për të përdorur metodat e reja mesimdhënëse dhe kurrikulat.



### Shtylla nr III Edukimi kreativ i fëmijëve romë

Procesi i të menduarit krijues dhe edukimi janë jashtëzakonisht të theksuara gjatë 5 viteve të fundit, duke synuar rritjen e interesit në procesin e shkollimit dhe leximit të fëmijëve dhe adoleshentëve. Procesi përdoret shpesh për fëmijët me probleme fokusi dhe emigrantët. Prezantimi i njohurive në aspektin e lojrave dhe procesit të konkurrencës është gjithmonë mjet i fuqishëm dhe efektiv.

### Me fjalë të tjera...

Qasja e romëve në arsim varet drejtpërdrejt nga standardi i arsimit që u ofrohet atyre. Shpesh vihet re se standardi i arsimit shkollor që u jepet fëmijëve romë është më i ulët se ai i dhënë për pjesën e mbetur të popullsisë. Mungesa e motivimit të mësuesve për të punuar me fëmijët e një kulture tjetër, paragjykimet ndaj familjeve romë dhe mungesa e trajnimeve janë faktorë që kontribuojnë në nivelin e ulët të arsimit të ofruar për romët. Nëpërmjet kësaj qasjeje, popullsia sigurohet me mjete dhe kompetenca për t'i ndihmuar ata që të kuptojnë kulturën romë dhe romët u sigurohen me mjete dhe kompetenca për të kuptuar kulturën e përgjithëshme. Si rezultat, nxitja e mirëkuptimit reciprok ndihmon në parandalimin e paragjykimeve nga të dyja palët. Megjithatë, kjo qasje nuk nënkupton që duhet të bëhen lëshime lidhur me të drejtat themelore të njeriut.

### Si mund të arrihet kjo në praktikë?

- Kurrikula krijuese dhe materialet e mësimit për mësuesit;
- Kurse hyrëse dhe konkurse kombëtare;
- Fonde kombëtare shtesë për edukimin krijues;



### Shtylla nr IV Mbështetja e arsimit të lartë për fëmijët dhe të rinjtë romë

Qëllimi i shtyllës aktuale është të kontribuojë në shfaqjen e një numri të konsiderueshëm të të diplomuarve romë, të arsimit të lartë, të sigurt dhe krenar për identitetin e tyre rom, të pajisur me aftësi dhe kompetenca që u mundësojnë atyre të bëhen profesionistë në fushat e tyre si dhe mbeten të lidhura ngushtë me komunitetin rom dhe mbështesin avancimin dhe përfshirjen e mëtejshme në shoqërinë e gjerë.

### Me fjalë të tjera...

Roli i ndërmjetësve, asistentëve dhe mësuesve të shkollave në procesin arsimor është shumë i rëndësishëm për zbatimin efektiv të procesit të integrit. Fëmijët romë duhet të mbështeten nga mësime dhënësit, të cilët janë trajnuar për të punuar me grupin specifik ose asistentët / ndërmjetësit që të jenë aktivisht të përfshirë në procesin e përditshëm të arsimit.

### Si mund të arrihet kjo në praktikë?

- Krijimi i kurrikulave të trajnuese për mësuesit që punojnë me fëmijët romë;
- Diplomë universitare për mësuesit që punojnë në arsimin bazë me gjuhën romë dhe punojnë në shkolla me ndasi kulturore;
- Shkëmbime eksperiencash;



### Shtylla nr V

#### Zhvillimi Profesional i mësimdhënies së fëmijëve dhe të rinjve Romë

